

VENDIM
Nr.631, datë 29.9.2007

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM , TË KOMUNËS MOLLAS TË QARKUT TË ELBASANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Mollas të qarkut të Elbasanit, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Mollas të qarkut të Elbasanit, miratuar me vendimin nr.18, datë 7.1.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Mollas të qarkut të Elbasanit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Mollas për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

Lidhja 1

Komuna Mollas

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-5	Prona që përdoren për realizimin e programeve mësimore;	Në pronësi
6	Prona që përdoren në fushën e kulturës dhe sportit;	Në pronësi
7	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik;	Në pronësi
9-13	Infrastrukturë (sheshe);	Në pronësi
14-39	Shërbimi funeral;	Në pronësi
40-46	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik;	Në pronësi
154-248;330-418	Infrastrukturë (rrugë vendore);	Në pronësi
304	Prona që shërbejnë për furnizimin me ujë të pijshëm;	Në pronësi
110;111;116;117;118;119;121;125-127;131-134;139-141;145-147;151-153;250;254;257;258;273;	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproductive);	Në pronësi
106-109;112-115;120;122-124;128-130;135-138;142-144;148-150	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive);	Në përdorim

